

VENDIM

Nr. 187, datë 25.11.2019

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “MP-HEC” SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “NIÇË”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 2270 kw

(korrigjuar me korrigjimin material të botuar në Fletoren Zyrtare nr. 176, datë 23.12.2019; ndryshuar me vendimin nr. 74, datë 22.4.2020; nr. 168, datë 15.5.2023)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa “a”; të nenit 5, pika 1, germa “a” dhe të nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016; dhe të nenit 15 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 25.11.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes nr. 110/4 prot., datë 18.11.2019, mbi licencimin e shoqërisë “MP-HEC” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 128, datë 29.8.2019, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “MP-HEC” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje u krye njoftimi në medien e shkruar, me shkresën nr. 32/39, datë 30.8.2019, dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “MP-HEC” sh.p.k.

- Me shkresën nr. 492/1 prot., datë 30.8.2019, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar.

- Me shkresën e protokolluar në ERE, me nr. 492/2 prot., datë 9.9.2019, shoqëria “MP-HEC” sh.p.k. ka përcjellë dokumentacionin e munguar.

- Shoqëria “MP-HEC” sh.p.k. është një subjekt tregtar i krijuar si detyrim ligjor i nenit 8 të Kontratës Koncesionare të formës BOT, me nr. 311 rep. dhe nr. 45 kol., datë 2.2.2009, “Për ndërtimin e HEC “Niçe”, të lidhur ndërmjet bashkimit të përkohshëm të shoqërisë “DEVY” sh.p.k. me “ZYFI” sh.p.k., në cilësinë e koncesionarit dhe autoritetit kontraktues, Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në zbatim të VKM-së nr. 217, datë 21.2.2008, “Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për ndërtimin me koncesion të HEC “Niçe”. Kjo shoqëri, është regjistruar në QKB, në datën 26.2.2009, konform ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, mban NUIS: K93826001D dhe mban statusin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar dhe zotërohet nga ortaku i vetëm “Energy Albania Group” sh.p.k.

- Kontrata e koncesionit nr. 311 rep. dhe nr. 45 kol., datë 2.2.2009, ka një afat 35-vjeçar që fillon nga data efektive e saj (data e nënshkrimit).

- Shoqëria ka bërë me dije në kërkesën e saj për licencim, se ka përfunduar punimet e veprës dhe pret të kryejë kolaudimin e saj.

- Shoqëria, me shkresën nr. 492/2 prot., datë 9.10.2019, ka përcjellë komunikimet shkresore me AKBN-në dhe MIE-n, në lidhje me konfirmimet e tyre për pjesëmarrjen në testimin e veprës dhe shtyrjen e kryerjes së testimit në një kohë të dytë, për shkak të thatësirës dhe mungesës së ujit.

- Shoqëria "MP-HEC" sh.p.k. ka depozituar kontratën e qirasë me nr. 9669 rep., nr. 5663 kol., datë 12.12.2016, "Për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor kombëtar", të lidhur midis Bashkisë Maliq dhe shoqërisë "MP-HEC" sh.p.k., për dhënien me qira të sipërfaqes prej 1.3024 ha e ndarë në 3.066 km shtrirje tubacioni/kanal dhe 0.19 km rrugë ndihmëse. Kjo është pjesë e fondit pyjor/kullosor publik, ekonomia pyjore në administrim të Bashkisë Maliq "Mesmal" dhe "Lozhan", ngastrat nr. 162/a, 175/a, 176/a të ekonomisë pyjore "Mesmal"; nr. 11/a, 13/a të ekonomisë pyjore "Lozhan", në përputhje me raportin teknik dhe të Agjencisë së Pyjeve dhe Kullotave.

- Afati i kësaj kontrate do të jetë deri më 12.12.2025, me të drejtë ripërtëritjeje, sipas afatit të Kontratës së Koncesionit nr. 311 rep.; nr. 45 kol., datë 2.2.2009 (neni 3 i kontratës).

- Shoqëria "MP-HEC" sh.p.k. ka depozituar kontratën e qirasë me nr. 3458 prot., datë 28.9.2017, "Për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor kombëtar", të lidhur midis Bashkisë Pogradec dhe shoqërisë "MP-HEC" sh.p.k., për dhënien me qira të sipërfaqes në cungishtë (tubacion presioni) 1.542 km, rrugë ndihmëse në funksion të ndërtimit të trasesë së vendosjes së tubacionit të presionit 0.31 km, si dhe pakësim në volum e dhënie në përdorim të sipërfaqes prej 0.412 ha dhe 1.676 ha për ndërtimin e HEC "Niçë", me kufizimet dhe koordinatat, sipas hartës pyjore ku është pasqyruar vendndodhja e HEC-it.

- Kontrata e qirasë e sipërcituar, lidhet për një afat 10-vjeçar, duke filluar nga dita e nesërme e nënshkrimit të kontratës dhe palët kanë të drejtë të rinovojnë afatin e kësaj kontrate në zbatim të afatit të kontratës së koncesionit nr. 311 kol., nr. 115 rep., datë 2.2.2009.

- Shoqëria ka përcjellë në ERE shkresën e OSHEE-së me nr. 22633/3 prot., datë 24.10.2017, me anë të së cilës kjo e fundit ka miratuar pikën e lidhjes për HEC "Niçë", në rrjetin elektrik të shpërndarjes për kapacitetin e instaluar 2340 kw. HEC "Niçë" do të lidhet me rrjetin e shpërndarjes nëpërmjet zbarave 35/6 kV, në nënstacionin elektrik Lozhan.

- Shoqëria ka paraqitur lejen e Këshillit të Basenit Ujëmbledhës Shkumbin, "Për përdorim të rezervës ujore", me nr. vendimi VI/5, datë 17.2.2010, lëshuar shoqërisë "DEVY" sh.p.k., në cilësinë e shoqërisë kryesuese të bashkimit të shoqërive, që kanë nënshkruar kontratën e koncesionit me MIE-n, për përdorim nga HEC-i, në rezervën ujore të Përroit Velçan, në sasinë 1100 l/sek. Vlefshmëria e kësaj leje përkon me afatin e kontratës së koncesionit.

- Shoqëria ka depozituar në ERE vendimin nr. 30, "Aktmiratimi për leje mjedisore", lëshuar për shoqërinë "MP-HEC" sh.p.k., për HEC "Niçë", me kapacitet të instaluar 990.72 kw.

- Nga analizimi rezulton se kapaciteti i instaluar prej 990.72 kw i pasqyruar në vendimin nr. 30, "Aktmiratimi për leje mjedisore", lëshuar për shoqërinë "MP-HEC" sh.p.k., për HEC "Niçë", është i ndryshëm nga ai që ka miratuar MIE, me shkresën nr. 11965/1 prot., datë 13.12.2018, sipas projektit të zbatimit të përmirësuar.

- Shoqërisë iu kërkua që të paraqesë këtë leje në përputhje me parametrat e ndryshuar dhe të miratuar nga MIE. Në vijim të sa kërkohet nga ERE, shoqëria "MP-HEC" sh.p.k., ka bërë me dije se ka aplikuar pranë Ministrisë së Mjedisit për marrjen e miratimit të vlerësimit të ndikimit në mjedis, të parametrave të ndryshuar të saj, me shkresë nr. 7364 prot., datë 16.7.2019, të cilën e ka përcjellë edhe në ERE.

- Në përgjigje të shkresës së ERE-s, me nr. 492/7 prot., datë 28.10.2019, me anë të së cilës iu kërkua shoqërisë "MP-HEC" sh.p.k., paraqitja e lejes në përputhje me parametrat e ndryshuar dhe të miratuar nga MIE, shoqëria, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 492/8, datë 6.11.2019, ka deklaruar sërish se është në pritje të përgjigjes së MIE-s.

- Duke qenë se prurjet mesatare janë rritur me ndryshimin e projektit nga 1.1 m³/s në 3.5 m³/s, shoqëria "MP-HEC" sh.p.k. duhet të përcjellë në ERE lejen e Këshillit të Basenit Ujëmbledhës Shkumbin, "Për përdorim të rezervës ujore", të rinovuar sipas parametrave të ndryshuar.

- Duke qenë se “Aktmiratimi për leje mjedisore”, lëshuar për shoqërinë “MP-HEC” sh.p.k., për HEC “Niçë”, me kapacitet të instaluar 990.72 kw, nuk përputhet me parametrat e ndryshuar nga MIE, me shkresën nr. 11965/1 prot., datë 13.12.2018, shoqëria “MP-HEC” sh.p.k., duhet të përcjellë në ERE, “Aktmiratimi për leje mjedisore”, të rinovuar sipas parametrave të ndryshuar.

- Nga analiza e dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria “MP-HEC” sh.p.k., rezulton se subjekti ka plotësuar pjesërisht kërkesat e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- formati dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, germet “a”, “b”, “c”: plotësuar;
 - dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, germet “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”: plotësuar pjesërisht;
 - shoqëria koncesionare “MP-HEC” sh.p.k. nuk ka depozituar në ERE kontratën shtesë të koncesionin, në vijim të miratimit nga MIE të projektit të zbatimit të përmirësuar të HEC “Niçë”;
 - dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, germet “a”, “b”, “c”, “d”: plotësuar;
 - dokumentacioni teknik për HEC-in, neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, germet “a”, “b”, “c”, “d” dhe pika 4.1.4, germet “a”, “b”, “c”, “d”, “e”: plotësuar;
 - leje nga institucione të tjera, neni 9, pika 4.1.5, germet “a”, “b”, “c”: plotësuar pjesërisht.
- Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “MP-HEC” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Niçë”, me kapacitet të instaluar 2270 kw, për një afat 24 vjet e 2 muaj, me kusht që:

a) *Shfuqizuar.*

b) *Shfuqizuar.*

c) *Shfuqizuar.*

2. *Shoqëria duhet të depozitojë në ERE kontratat e qirasë të rinovuara, përkatësisht brenda datës 12.12.2025, kontratën e rinovuar me Bashkinë Maliq, dhe brenda datës 29.9.2027, kontratën e rinovuar me Bashkinë Pogradec, ose çdo dokument tjetër që rregullon pronësinë në zonën ku shtrihet projekti.*

3. *Shfuqizuar.*

4. Mosplotësimi i kushteve të këtij vendimi përbën shkak për rishikimin e tij.

5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTARE E BORDIT TË ERE-s
Eriola Sadushi